



QËNDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE

M A T U R A S H T E T Ë R O R E 2 0 2 0

RAPORT PUBLIK

MBI

ARRITJET E NXËNËSVE

TIRANË, Dhjetor 2020

Përmbajtja

<i>Hyrje</i>	3
<i>Metodologjia</i>	4
<i>Gjetjet kryesore</i>	10
I Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi	12
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	12
2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës Shqipe dhe Letërsisë</i>	26
3 <i>Arritjet e nxënësve në Gjuhë Shqipe dhe Letërsi - statistika krahasuese</i>	31
II Lënda: Matematikë	
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	40
2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Matematikës</i>	51
3 <i>Arritjet e nxënësve në Matematikë - statistika krahasuese</i>	55
III Lënda: Gjuhë e Huaj	
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	63
2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës së Huaj</i>	78
3 <i>Arritjet e nxënësve në Gjuhën e Huaj - statistika krahasuese</i>	82
IV Lëndët me Zgjedhje	
1 <i>Arritjet e Nxënësve</i>	91
2 <i>Faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të lëndëve me zgjedhje</i>	131
V Aneksë	132

Hyrje

Viti 2020 na përballi me një situatë të pazakontë, atë të COVID 19. Izolimi që shkaktoi pandemia e vendosi edhe sektorin e arsimit në një gjendje tërësisht të vështirë. Mësimi tradicional në klasa, u zëvendësua me atë on-line. Por edhe ky i fundit u shoqërua me problematika nga më të ndryshmet. Këto rënduan procesin e mësimdhënies dhe të të nxënësve në të gjitha nivelet e arsimit. Padyshim, vështirësoi edhe punën e maturantëve, duke patur parasysh që përfundimi i studimeve të tyre finalizohet me provimet e Maturës Shtetërore. Megjithatë, duke ditur rëndësinë që kanë këto provime në diplomim dhe në vijimin e mëtejshëm të studimeve, pavarësisht kushteve të vështira, u mor vendimi që këto provime të zhvilloheshin në kohën e duhur.

Tashmë që Matura 2020 konsiderohet e përfunduar me të dy sesionet e saj, QSHA, sikurse ka bërë që nga Matura e parë Shtetërore (2006), po publikon Raportin Publik.

Ky raport publik shërben si material burimor për grupe të ndryshme interesi, ku ndër të parët renditim institucionet politikëbërësit të fushës së arsimit në nivel kombëtar dhe rajonal, më pas institucionet kërkimore, të cilat kërkojnë të dhëna për analiza, dhe së fundmi komunitetit të gjerë të prindërve të nxënësve, të cilët duan të monitorojnë se si shkollat ku studiojnë fëmijët e tyre po përparojnë në arritjen e standardeve të mësimdhënies dhe të të nxënësve.

Edhe pse Raporti Publik - Matura Shtetërore 2020 jep informacion që mundëson krahasimin e arritjeve të nxënësve mes ZVA, theksojmë se, qëllimi kryesor i tij është njohja e nivelit të arritjeve të nxënësve maturantë në nivel kombëtar, bazuar në rezultatet e një vlerësimi të jashtëm të standardizuar si edhe krahasimi i tij me arritjet vjetore të nxënësve gjatë vitit shkollor 2019-2020.

Në këtë raport nuk është përfshirë në detaje krahasimi i arritjeve të nxënësve të Maturës 2020 me ato të maturave të viteve të kaluara, për shkak të ndryshimit të formatit të testit. Ky ndryshim u ndikua për arsye të pandemisë. Si pasojë u kalua nga një test i formatit me pyetje të llojeve të ndryshme (me alternativa, me zhvillim dhe ese) në atë të një testi me pyetje vetëm me alternativa.

Metodologjia

Informacioni statistikor i këtij raporti është bazuar në databazën e krijuar nga QSHA gjatë procesit të organizimit dhe realizimit të provimeve të Maturës Shtetërore 2020.

Për realizimin me sukses të Maturës Shtetërore 2020, QSHA përdor dy sisteme, të cilat janë:

- Matura Shtetërore, i cili përmban të gjithë rezultatet për provimet e detyruara të Maturës Shtetërore 2020
- Maturanti, i cili përdoret për gjenerimin e certifikatave të Maturës Shtetërore, si dhe gjenerimin e mesatares sipas VKM për pranimet në IAL. *Theksojmë se: rezultatet vjetore që kanë marrë nxënësit gjatë viteve të shkollimit, hidhen në këtë sistem nga mësuesit ose drejtuesit e shkollave; përgjithësisht shkollat kanë plotësuar dhe konfirmuar të dhënat për nxënësit të cilët marrin diplomë dhe certifikatë të MSH. Për nxënësit që nuk kanë notë vjetore të hedhur në sistem rezultojnë të jenë:*
 - a) *nxënës mbetës qoftë edhe në një prej provimeve të Maturës Shtetërore 2020, dhe shkollat nuk kanë konfirmuar notat e tyre, pra nuk janë të ruajtura në sistem*
 - b) *nxënës që në maturë nuk e zhvillojnë atë lëndë/lëndët e Maturës Shtetërore 2020, p.sh shkollat profesionale, gjimnazi part -time, social artistike.*

Baza e të dhënave përmban informacion statistikor në nivel nxënësi mbi arritjet në lëndët gjuhë shqipe dhe letërsi, matematikë, gjuhë e huaj, si dhe lëndët me zgjedhje.

Fushat kryesore të bazës së të dhënave të QSHA janë:

- numri identifikues i nxënësit (ID),
- gjinia e nxënësit,
- ZVA (së cilës i përket shkolla që ka frekuentuar nxënësi),
- lloji i shkollës (publike/private),
- vendndodhja e shkollës (fshat/qytet),
- profili i studimeve që ka ndjekur nxënësi (gjimnaz, gjimnaz gjuhësor, arsim profesional, social-artistik),
- sistemi i studimeve që ka ndjekur nxënësi (me kohë të plotë/me kohë të pjesshme),
- viti shkollor kur nxënësi ka mbaruar studimet e shkollës mesme,
- kalueshmëria gjatë vitit shkollor,
- testet në provimet e maturës (që janë dhënë nga çdo nxënës),
- pikët e fituara në teste nga çdo nxënës,
- notat në provimet e Maturës Shtetërore,
- notat vjetore të fituara nga nxënësit gjatë vitit shkollor

Raport Publik Mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2020

Të dhënat mbi arritjet mesatare të nxënësve për testet e dhëna nga nxënësit në provimet e Maturës Shtetërore 2020 janë paraqitur:

- në nivel kombëtar,
- në nivel ZVA,
- sipas urbanizimit – fshat/qytet,
- sipas gjinisë - femra/meshkuj,
- sipas profilit të shkollës që ka ndjekur nxënësi.

Në përpunimin statistikor të të dhënave, janë përfshirë të dhënat e arritjeve të nxënësve maturan të vitit shkollor 2019-2020, të cilët morën pjesë në provimet e Maturës Shtetërore 2020, sesioni i qershorit.

Në **tabelën e mëposhtme T-1** është paraqitur numri i nxënësve sipas lëndëve/provimeve të detyruara të Maturës Shtetërore 2020, të klasifikuar sipas kategorive publik/privat, fshat/qytet, femra/meshkuj, arritjet e të cilëve janë përdorur për përgatitjen e këtij raporti.

Tabela T-1

Nr.	Lënda e Provimit të detyruar	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Nr.	Lënda e Provimit të detyruar	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim		
		Total	Publik	Privat			Total	Publik	Privat
1	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	30434	26313	4120	1	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	30434	26313	4120
	Qytet	24032	20088	3944		Femra	15390	13263	2126
	Fshat	6401	6225	176		Meshkuj	15044	13053	1994
2	Matematikë	30399	26275	4123	2	Matematikë	30399	26275	4123
	Qytet	24014	20067	3947		Femra	15375	13249	2125
	Fshat	6384	6208	176		Meshkuj	15024	13026	1998
3	Gjuhë e Huaj	30421	26298	4121	3	Gjuhë e Huaj	30421	26298	4121
	Qytet	24029	20084	3945		Femra	15381	13254	2127
	Fshat	6390	6214	176		Meshkuj	15038	13044	1994

Përpunimi i të dhënave u realizua nëpërmjet software -ve Statistika dhe SPSS.

Informacioni statistikor i përfutur nga përpunimi është paraqitur në formë tabelare dhe/ose grafike.

Raporti përmban këta tregues statistikorë:

- Mesatarja e pikëve të fituara në testim,
- Nota mesatare Vjetore - (NV),
- Nota mesatare e Maturës - (NM),
- Shmangia standarde – (shmangia mesatare e të dhënave nga mesatarja e tyre),
- Nota mesatare Vjetore në nivel kombëtar - (NVk),

- Nota mesatare e Maturës në nivel kombëtar - (NMk),
- Kalueshmëria në provimin e Maturës,
- Diferenca e Notës Vjetore me Notën Vjetore në nivel kombëtar - (NV – NVk),
- Diferenca e Notës së Maturës me Notën e Maturës në nivel kombëtar - (NM – NMk),
- Diferenca e Notës së Maturës me Notën Vjetore - (NM – NV).

Statistika përmbledhëse për MSH 2020

Tabela e mëposhtme T-2 paraqet të dhëna statistikore përmbledhëse për provimet e Maturës Shtetërore 2020 për sesionin e qershorit, si dhe sesionin qershor dhe vjeshtë (të marra së bashku).

Numri i nxënësve në sesionin e qershorit dhe vjeshtës së bashku është më i madh, krahasuar me numrin e nxënësve në sesionin e qershorit, sepse në provimet e vjeshtës testohen jo vetëm ata nxënës që kanë mbetur në sesionin e qershorit, por edhe ata nxënës, të cilët kanë qenë mbetës gjatë vitit shkollor në dy lëndë vjetore në Maturën Shtetërore 2020.

Dhënia e lëndëve/provimeve në sesionin e vjeshtës, si nga nxënësit që kanë rezultuar mbetës në provimet e Maturës Shtetërore në sesionin e qershorit, po ashtu edhe nga nxënësit mbetës në jo më shumë se 2 lëndë vjetore, ndikon në rritjen e kalueshmërisë, në përfundim të të gjithë procesit, të Maturës Shtetërore 2020.

Tabela T-2

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në provimin e Maturës	Nota mesatare Vjetore
		Total	Publik	Privat	(në %)		
Sesioni i Qershorit							
1	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	30434	26313	4120	97.20%	7.28	7.12
2	Matematikë	30399	26275	4123	98.05%	7.54	6.70
3	Gjuhë e Huaj	30421	26298	4121	96.20%	7.83	7.32
4	Lëndë me Zgjedhje	30346	26256	4090	98.64%	7.56	7.37
Të gjitha lëndët		121600	105142	16454	97.52%	7.55	7.12
Sesioni i Qershorit dhe Vjeshta							
1	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	30659	26498	4161	99.76%	7.17	7.20
2	Matematikë	30637	26479	4158	99.75%	7.52	6.69
3	Gjuhë e Huaj	30658	26496	4162	99.60%	7.90	7.30
4	Lëndë me Zgjedhje	30622	26467	4155	99.82%	7.58	7.35
Të gjitha lëndët		122576	105940	16636	99.73%	7.54	7.13

Tabela e mëposhtme T-3 jep disa statistika lidhur me numrin e nxënësve që gjatë procesit mësimor janë vlerësuar me notën 10.00, si dhe sa prej tyre kanë marrë vlerësime 10.00 në një, dy, tre ose katër provimet e Maturës Shtetërore 2020, sipas ZVA.

Nga tabela tregon se, nga numri i nxënësve që janë vlerësuar me notën 10.00 gjatë procesit mësimor,

- asnjë prej tyre nuk ka arritur të marrë vlerësimin 10.00 në **katër** provimet e MSH 2020,
- 3 prej tyre kanë arritur të marrë vlerësimin 10.00 në **tre** provimet e MSH 2020,
- 27 prej tyre kanë arritur të marrë vlerësimin 10.00 në **dy** provimet e MSH 2020,
- 201 prej tyre kanë arritur të marrë vlerësimin 10.00 në **një** provim të MSH 2020,
- 283 nxënës në Tiranë dhe 120 në Durrës kanë mesataren 10.00 për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë.

Tabela T-3

Nr.	ZVA	Nr. i nxënësve me një mesatare 10 për të gjitha vitet e arsimit të mesëm të lartë	Nr. i nxënësve që janë vlerësuar me notën e shkallëzuar 10.00 në një nga provimet e MSH 2020	Nr. i nxënësve që janë vlerësuar me notën e shkallëzuar 10.00 në dy provime të MSH 2020	Nr. i nxënësve që janë vlerësuar me notën e shkallëzuar 10.00 në tre provime të MSH 2020	Nr. i nxënësve që janë vlerësuar me notën e shkallëzuar 10.00 në katër provime të MSH 2020
1	BERAT	37	6			
2	BULQIZË	6				
3	DELVINË-FINIQ	2				
5	DEVOLL	4	1			
6	DIBËR	3		1		
7	DIVJAKË	8	1			
8	DURRËS	120	20	2		
9	ELBASAN	44	11			
10	FIER	65	11	3		
11	GRAMSH	10	2	1		
12	GJIROKASTËR-LIBOHOVË-DROPULL	11	1			
13	HAS	14	4	1		
14	KAMËZ	8	1			
15	KAVAJË	20	12	2		
16	KLOS	1				
17	KOLONJË	5				
18	KORÇË - PUSTEC	32	7	2		
19	KRUJË	11	1			
20	KUÇOVË	7				
21	KUKËS	28	8		1	
22	KURBIN	17	2			
23	LEZHË	22	5			
24	LIBRAZHD	8				
25	LUSHNJE	57	9	4		

Raport Publik Mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2020

26	MALËSI E MADHE	1				
27	MALIQ	2				
28	MALLAKASTËR	5	1			
29	MAT	5				
30	MIRDITË	4				
31	PATOS	5	1			
32	PEQIN	7	2			
33	PËRMET-KËLCYRË	3				
34	PËRRENJAS	5	1			
35	POGRADEC	32	2	2		
36	PUKË-FUSHË ARRËS	5				
37	ROSKOVEC	8				
38	RROGOZHINË	3				
39	SARANDË- KONISPOL	10	2		2	
40	SKRAPAR - POLIÇAN	3				
41	SHIJAK	2				
42	SHKODËR	33	5	2		
43	TEPELENË- MEMALIAJ	8	1			
44	TIRANE	283	65	6		
45	TROPOJË	8				
46	URA VAJGURORE	5				
47	VLORË-HIMARË	78	19	1		
48	VORE	1				
TOTAL		1056	201	27	3	0

Statistika përmblledhëse për MSH 2019

Tabela e mëposhtme T-4 paraqet të dhëna statistikore përmblledhëse për provimet e Maturës Shtetërore 2019 për sesionin e parë, si dhe sesionin e parë dhe të dytë.

Tabela T-4

Nr.	Lënda	Numri i nxënësve që morën pjesë në provim			Kalueshmëria në provim	Nota mesatare në provimin e Maturës	Nota mesatare Vjetore
		Total	Publik	Privat	(në %)		
Sesioni i Qershorit							
1	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	34970	30207	4763	95.40%	6.39	7.44
2	Matematikë	34940	30174	4766	94.43%	6.35	6.81
3	Gjuhë e Huaj	34971	30207	4764	96.90%	7.39	7.47
4	Lëndë me Zgjedhje	34919	30163	4756	96.23%	7.88	7.93
Të gjitha lëndët		139800	120751	19049	95.99%	6.85	7.44
Sesioni i Qershorit dhe Vjeshta							
1	Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	35729	30920	4809	98.17%	6.40	7.42
2	Matematikë	35711	30903	4808	97.92%	6.37	6.80
3	Gjuhë e Huaj	35730	30918	4812	99.6%	7.38	7.48
4	Lëndë me Zgjedhje	35628	30873	4809	98.43%	7.27	7.91
Të gjitha lëndët		142798	123614	19238	98.20%	6.86	7.41

Statistika krahasuese për MSH 2020 dhe MSH 2019

Nga krahasimi i të dhënave të MSH 2020 me MSH 2019, **në sesionin e parë**, për të gjitha lëndët rezulton se:

- Kalueshmëria në provim, është rritur me 1.22 %.
- Nota mesatare në provimin e maturës është rritur me 0.7 njësi note.
- Nota mesatare vjetore, është ulur me 0.32 njësi note.

Nga krahasimi i të dhënave të MSH 2020 me MSH 2019, **në sesionin e parë dhe të dytë**, për të gjitha lëndët rezulton se:

- Kalueshmëria në provim, është rritur me 1.31 % .
- Nota mesatare në provimin e maturës është rritur me 0.68 njësi note.
- Nota mesatare vjetore, është ulur me 0.28 njësi note.

Gjetjet kryesore _Matura Shtetërore 2020

Ndër gjetjet kryesore të këtij raporti publik përmendim:

- ❖ Rritja e konsiderueshme e notës mesatare në nivel kombëtar ka ardhur si rrjedhojë e ndryshimit të formatit të testit nga pyetje me zhvillim dhe me alternativa **në një test me pyetje vetëm me alternativa.**
- ❖ **Arritjet mesatare të nxënësve gjatë procesit mësimor janë më të ulëta, krahasuar me arritjet në provimet e Maturës Shtetërore 2020.**
- ❖ Arritjet mesatare të vajzave në nivel kombëtar janë më të larta se të djemve.
- ❖ Arritjet e nxënësve, që kanë ndjekur shkollën në qytet, janë dukshëm më të larta, krahasuar me ata që kanë ndjekur shkollën në fshat. Arritjet mesatare të vajzave në qytet janë më të larta kundrejt arritjeve mesatare të vajzave në fshat.
- ❖ Nxënësit e sistemit publik kanë shkallë më të lartë të qëndrueshmërisë së arritjeve në provimin e Maturës Shtetërore kundrejt arritjeve vjetore, krahasuar me nxënësit e sistemit privat. Kjo situatë është e vlefshme për kategoritë: femra/meshkuj dhe qytet/fshat.
- ❖ Dukuria e diferencës me më shumë ose më pak se 2, 3 ose 4 nota midis rezultateve të nxënësve në provimet e Maturës Shtetërore 2020 kundrejt rezultateve vjetore të tyre, tregon për një paqëndrueshmëri të arritjeve. Paqëndrueshmëria ndikohet nga cilësia në vlerësimin e nxënësve gjatë procesit mësimor, si dhe nga cilësia e administrimit të mjediseve ku zhvillohen provimet e Maturës Shtetërore.
- ❖ Vlerësimi i nxënësve gjatë procesit mësimor është ndikuar edhe nga dy faktorë, të cilët janë:

- Rritja e peshës së rezultateve vjetore, e cila sipas VKM-së e përcakton atë të barabartë me peshën e rezultateve të provimeve të maturës. Sipas formulës së përcaktuar në VKM, për pranimet në Institucionet e Arsimit të Lartë, të dy elementët e mësipërm kanë peshë 50% në përllogaritjen e mesatares.
- Disa nga programet e studimit kanë të përcaktuar në formulën e përllogaritjes së pikëve për konkurs/pranim në Institucionet e Arsimit të Lartë edhe rezultatet vjetore të një ose disa lëndëve me zgjedhje që zhvillohen gjatë viteve të arsimit të mesëm të lartë. Një mesatare më e lartë në vitet e shkollimit rrit shansin për nxënësit që të arrijnë kufirin e përcaktuar me VKM për pranim në Institucionet e Arsimit të Lartë.

I. Lënda: Gjuhë shqipe dhe letërsi

1) Arritjet e Nxënësve

Tabela GJ-L-1 jep informacion rreth arritjeve mesatare të nxënësve për lëndën e Gjuhës shqipe dhe letërsisë në nivel kombëtar, sipas **urbanizimit fshat/qytet** (referuar vendndodhjes së shkollës), sipas **gjinisë femra/meshkuj**, si edhe sipas sistemit **publik/privat të edukimit**.

Tabela GJ-L-1

		Pikët e fituara në test		Nota e MSH		Nota Vjetore	
Urbanizimi	Gjinia	Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
	Femra	35.02	8.58	7.47	1.2	7.96	1.50
Total	Meshkuj	30.67	8.55	6.86	1.21	6.43	1.53
	Total	32.86	8.83	7.17	1.24	7.20	1.70
	Femra	36.01	8.53	7.61	1.18	8.06	1.49
Qytet	Meshkuj	31.49	8.62	6.97	1.22	6.55	1.50
	Total	33.75	8.87	7.29	1.24	7.31	1.70
	Femra	31.44	7.42	6.4	1.07	7.61	1.48
Fshat	Meshkuj	27.44	7.78	6.9	1.11	5.96	1.34
	Total	29.53	7.86	6.70	1.13	6.82	1.64
	Femra	34.25	8.41	7.37	1.18	7.81	1.50
Publik total	Meshkuj	29.75	8.15	6.73	1.16	6.21	1.43
	Total	32.01	8.58	7.05	1.21	7.02	1.67
	Femra	35.24	8.41	7.51	1.17	7.89	1.50
Qytet	Meshkuj	30.50	8.25	6.84	1.17	6.30	1.45
	Total	32.86	8.66	7.17	1.22	7.09	1.67
	Femra	31.17	7.62	6.94	1.09	7.57	1.48
Fshat	Meshkuj	27.20	7.25	6.36	1.05	5.91	1.31
	Total	29.27	7.71	6.66	1.11	6.78	1.62
	Femra	39.80	8.04	8.13	1.08	8.87	1.16
Privat total	Meshkuj	36.58	8.65	7.69	1.19	7.85	1.44
	Total	38.23	8.49	7.91	1.16	8.37	1.40
	Femra	39.77	8.07	8.12	1.09	8.87	1.16
Qytet	Meshkuj	36.57	8.68	7.69	1.20	7.85	1.45
	Total	38.21	8.52	7.91	1.16	8.37	1.40
	Femra	40.23	7.50	8.18	0.99	8.84	1.07
Fshat	Meshkuj	36.79	8.02	7.72	1.10	7.71	1.25
	Total	38.74	7.89	7.98	1.06	8.35	1.27

i. Në nivel kombëtar:

- mesatarja e pikëve të fituara në provimin e maturës në lëndën e Gjuhës shqipe dhe letërsisë është **32.86** pikë, me shmangie mesatare **8.83**,
- nota mesatare e Maturës Shtetërore është **7.17**, me shmangie mesatare **1.24**,
- ndërsa nota mesatare vjetore është **7.20**, me shmangie mesatare **1.70**.

Në nivel kombëtar rezulton se diferenca e notës mesatare të provimit të Maturës Shtetërore me notën mesatare vjetore është 0.03 njësi note.

ii. Arritjet sipas urbanizimit qytet/fshat:

Nëse analizojmë arritjet e nxënësve në nivel kombëtar, sipas elementëve të urbanizimit qytet/fshat, të paraqitura në tabelën GJ-L-1, rezulton se:

- ekzistojnë diferenca të konsiderueshme mes arritjeve të nxënësve që kanë ndjekur shkollën në qytet, kundrejt atyre që e kanë ndjekur shkollën në fshat. Mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit e qytetit rezulton të jetë rreth **4.22** pikë më e lartë kundrejt nxënësve të fshatit.
- diferenca prej **4.22** pikë në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën që ekziston mes dy kategorive në notën mesatare të Maturës Shtetërore, e cila arrin vlerën prej **0.59** njësi notë.

iii. Arritjet sipas gjinisë:

Krahasueshmëria mes arritjeve mesatare të vajzave dhe të djemve, për nivelin kombëtar, tregon se:

- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë.
- vajzat kanë rezultate më të larta krahasuar me djemtë, si në sistemin publik, po ashtu edhe në sistemin privat.
- vajzat kanë marrë një vlerësim më të ulët në provimin e Maturës Shtetërore, krahasuar me arritjet vjetore të tyre (nota mesatare në Maturën Shtetërore është **7.47** kundrejt **7.96** që është nota mesatare vjetore), ndërkohë që djemtë kanë marrë një vlerësim më të lartë në provimin e Maturës Shtetërore, krahasuar me notën e tyre vjetore (nota mesatare në Maturën Shtetërore është **6.86** kundrejt **6.43** që është nota mesatare vjetore).
- arritjet mesatare të vajzave në qytet janë më të larta, krahasuar me arritjet mesatare të vajzave në fshat. Mesatarja e pikëve të fituara në provimin e Maturës Shtetërore për vajzat në qytet është **4.57** pikë më e lartë, kundrejt vajzave në fshat.
- vajzat në qytet kanë një notë mesatare vjetore më të lartë, krahasuar me notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore (**0.45** njësi note më të lartë). Ndërsa vajzat në fshat kanë një notë mesatare vjetore më të lartë, krahasuar me notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore (**1.21** njësi note më të lartë).
- djemtë në qytet kanë arritje më të larta, krahasuar me arritjet e djemve në fshat.

- në sistemin privat rezulton që diferencat mes arritjeve të vajzave në qytet, me ato në fshat, janë më të ndryshme: vajzat në sistemin privat, në fshat, kanë **0.46** pikë më shumë në mesataren e përgjithshme të pikëve të vajzave në qytet. E njëjta gjë qëndron edhe për kategorinë djem, me diferencën **0.22** pikë.

iv. Arritjet sipas sistemit publik/privat të arsimit:

Diferenca të mëdha ekzistojnë edhe midis dy sistemeve arsimore publik e privat në sistemin tonë arsimor. Nga të dhënat e *Tabelës GJ-L-1* rezulton se:

- arritjet mesatare të nxënësve, në sistemin privat të edukimit, janë më të larta se arritjet mesatare të nxënësve në sistemin publik. Kjo situatë qëndron si për mesataren e pikëve në provim, po ashtu edhe për notën mesatare të Maturës Shtetërore dhe atë vjetore.
- ekzistenca e diferencës me **6.22** pikë në mesataren e pikëve pasqyrohet edhe në diferencën që ekziston mes dy kategorive në notën mesatare të Maturës Shtetërore, e cila arrin vlerën prej **0.86** njësi notë.

v. Qëndrueshmëria e arritjeve:

Nëse do të analizojmë qëndrueshmërinë e arritjeve të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore, kundrejt arritjeve vjetore, shihet se:

- nxënësit e sistemit publik kanë shkallë më të lartë të qëndrueshmërisë së arritjeve, krahasuar me nxënësit e sistemit privat. Kjo situatë është e vlefshme për kategoritë: femra/ meshkuj, si dhe qytet/fshat.
- në sistemin privat, arritjet mesatare në provimin e Maturës Shtetërore janë **0.46** njësi notë më të ulët, kundrejt arritjeve mesatare vjetore të tyre, ndërkohë që, për nxënësit e sistemit publik, arritjet mesatare ndryshojnë me një vlerë në rritje prej **0.03** njësi notë.

Rezulton se qëndrueshmëria e arritjeve mesatare të nxënësve është më e lartë në sistemin publik, kundrejt sistemit privat.

Tabela GJ-L-2 paraqet arritjet mesatare të nxënësve sipas **profilit të shkollës së ndjekur**, si dhe sipas **llojit të shkollës publike apo private**.

Tabela GJ-L-2

Profili i shkollës	Pikët e fituara në test		Nota e MSH		Nota Vjetore	
	Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
TOTAL	Gjimnaz	34.12	8.84	7.34	1.24	7.47
	Gjimnaz Gjuhësor dhe Seksioni dy gjuhësh	33.61	8.70	7.27	1.19	7.33
	Artistike; Koreografike, Sportive	30.18	6.70	6.80	0.96	6.64
	Teknike profesionale	27.67	6.70	6.44	0.97	6.15
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	26.31	6.29	6.24	0.91	5.67
PUBLIK	Gjimnaz	33.26	8.64	7.23	1.22	7.28
	Gjimnaz Gjuhësor dhe Seksioni dy gjuhësh	33.56	8.70	7.27	1.19	7.31
	Artistike; Koreografike, Sportive	30.18	6.70	6.80	0.96	6.64
	Teknike profesionale	27.17	6.73	6.36	0.92	6.05
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	26.31	6.29	6.24	0.91	5.67
PRIVAT	Gjimnaz	38.65	8.44	7.97	1.15	8.46
	Gjimnaz Gjuhësor dhe Seksioni dy gjuhësh	43.5	1.29	8.68	0.16	10.00
	Artistike; Koreografike, Sportive	-	-	-	-	-
	Teknike profesionale	33.56	7.66	7.28	1.08	7.32
	Gjimnaz -Me Kohë të Shkurtuar	-	-	-	-	-

Bazuar në të dhënat e tabelës GJ-L-2, për totalin e nxënësve dhe kategorinë publik/privat rezultojnë se:

- nxënësit që ndjekin shkollat në gjimnaz, kanë rezultate më të larta, krahasuar me nxënësit e profileve të tjera, si në rezultatet e Maturës Shtetërore, ashtu edhe në ato Vjetore 2020.
- referuar rezultateve të provimit të Maturës 2020, me arritje më të larta paraqiten nxënësit e shkollave - gjimnaz.
- referuar sistemit publik/privat, rezultojnë se në të dy sistemet arritjet më të larta i kanë nxënësit e profilit gjimnaz – gjuhësor dhe seksionit dy gjuhësh.

Në vijim **tabela GJ-L-3 dhe grafiku GJ-L-1** paraqesin shpërndarjen e notave (në përqindje) të provimit të Maturës Shtetërore për lëndën e Gjuhës shqipe dhe letërsisë.


Tabela GJ-L-3

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave të Provimit të Maturës Shtetërore (në %)						
		4	5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	0.17%	5.71%	13.79%	20.34%	21.65%	15.08%	2.39%
2	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni dy gjuhësh	0.00%	0.006%	0.06%	0.12%	0.25%	0.34%	0.08%
3	Artistike; Koreografike, Sportive	0.000%	0.11%	0.48%	0.60%	0.34%	0.08%	0.006%
4	Teknike profesionale	0.05%	2.05%	5.28%	4.92%	1.72%	0.43%	0.009%
Në nivel kombëtar (dita)		0.22%	7.87%	19.61%	25.98%	23.96%	15.93%	2.4%
5	Gjimnaz -me kohë të shkurtuar	0.02%	0.54%	1.23%	0.91%	0.27%	0.03%	0.00%
Në nivel kombëtar		0.24%	8.42%	20.84%	26.89%	24.23%	15.96%	2.49%

Në nivel kombëtar në provimin e Maturës Shtetërore:

- Kalueshmëria është **99.51%**.
- Nota me përqindjen më të lartë është nota **7** me **26.89%**.
- Notat **6, 7** dhe **8** kanë vlera në përqindje, shuma e të cilave përbën rreth **71.96 %** të totalit të nxënësve.
- Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **10** në provimin e Maturës Shtetërore është **2.49%**.

Grafiku GJ-L-1



Në vijim **tabela GJ-L-4 dhe grafiku GJ-L-2**, paraqesin shpërndarjen notave vjetore për lëndën e Gjuhës shqipe dhe letërsisë.


Tabela GJ-L-4

Nr.	Shkollat e Mesme sipas profilit të studimeve	Shpërndarja e Notave Vjetore (në %)						
		Pa notë nga shkolla	5	6	7	8	9	10
1	Gjimnaz	0.12	14.09	11.91	11.84	12.84	13.15	13.74
2	Gjimnaz gjuhësor dhe Seksioni dy gjuhësh	-	0.31	0.52	0.44	0.53	0.33	0.29
3	Artistike; Koreografike, Sportive	-	0.35	0.50	0.33	0.26	0.10	0.08
4	Teknike profesionale	0.02	5.97	4.01	2.04	1.29	0.75	0.39
Në nivel kombëtar (dita)		0.14	20.72	16.94	14.65	14.92	14.33	14.50
5	Gjimnaz –me kohë të shkurtuar	0.01	1.53	1.07	0.31	0.06	0.039	0.009
Në nivel kombëtar		0.15	22.25	18.01	14.96	14.98	14.36	14.50

Në nivel kombëtar në shpërndarjen e notës vjetore:

- Nota me përqindjen më të lartë është nota 5 me **22.25%**.
- Përqindja e nxënësve të vlerësuar me notën **10** është **14.50%**.

Grafiku GJ-L-2



Të dhënat mbi përqindjet e notave në nivel kombëtar, sipas **urbanizimit qytet/fshat**, si dhe **gjinisë femra/meshkuj**, për provimin e Maturës Shtetërore 2020 dhe për arritjet Vjetore 2020, janë dhënë në formë tabelare dhe grafike, përkatësisht në **Tabelën GJ-L-5** dhe **Tabelën GJ-L-6** dhe grafikët GJ-L-3 dhe GJ-L-4

Sipas urbanizimit:

Tabela GJ-L-5 Përqindjet e notave në nivel kombëtar

Matura Shtetërore 2020				Vjetore 2020			
Nota	Urbanizimi			Nota	Urbanizimi		
	Qytet	Fshat	Gjithsej		Qytet	Fshat	Gjithsej
Nota 4	0.14%	0.10%	0.25%	Pa notë	0.14%	0.01%	0.15%
Nota 5	5.69%	2.73%	8.42%	Nota 5	15.8%	6.45%	22.25%
Nota 6	14.87%	5.97%	20.84%	Nota 6	14.16%	3.85%	18.01%
Nota 7	20.71%	6.18%	26.89%	Nota 7	11.81%	3.15%	14.96%
Nota 8	19.93%	4.30%	24.23%	Nota 8	12.2%	2.79%	14.99%
Nota 9	14.61%	1.35%	15.96%	Nota 9	11.74%	2.62%	14.36%
Nota 10	2.36%	0.13%	2.49%	Nota 10	12.6%	1.90%	14.49%

Nga tabela vërejmë se përqindja e nxënësve që kanë marrë notën **10** në provimin e Maturës Shtetërore, është **2.49 %** e totalit të nxënësve, ku **0.13%** janë nxënës që i përkasin kategorisë fshat, dhe **2.36 %** janë nxënës që i përkasin kategorisë qytet.

- Rezultatet e fituara në Maturën Shtetërore 2020, si dhe ato Vjetore 2020, për nxënësit e shkollave të qytetit, janë më të larta, kundrejt nxënësve të fshatit.
- Përqindja e nxënësve që kanë marr notën 10 në Maturën Shtetërore, për të dyja kategoritë, është më e vogël nëse do ta krahasonim me arritjet vjetore. Por rënia e kësaj përqindjeje për nxënësit e qytetit është shumë më e madhe krahasuar me rënien e kësaj përqindjeje në fshat.
- Ka një diferencë të dukshme midis nxënësve në qytet që kanë marrë gjatë vitit notën 10 (12.6%), krahasuar me atë në fshat (1.90%). Kjo diferencë midis dy grupeve është më e vogël në Maturën Shtetërore.

Sipas gjinisë:

Tabela GJ-L-6 Përqindjet e notave në nivel kombëtar

Matura Shtetërore 2020				Vjetore 2020			
Nota	Gjinia			Nota	Gjinia		
	Femra	Meshkuj	Gjithsej		Femra	Meshkuj	Gjithsej
Nota 4	0.06%	0.18%	0.24%	Pa notë	0.04%	0.11%	0.15%
Nota 5	2.74%	5.68%	8.42%	Nota 5	2.91%	19.34%	22.25%
Nota 6	7.43%	13.41%	20.84%	Nota 6	7.19%	10.82%	18.01%
Nota 7	13.02%	13.87%	26.89%	Nota 7	8.53%	6.43%	14.96%
Nota 8	14.35%	9.88%	24.23%	Nota 8	9.77%	5.22%	14.99%
Nota 9	10.66%	5.30%	15.96%	Nota 9	10.38%	3.98%	14.36%
Nota 10	1.75%	0.74%	2.49%	Nota 10	11.22%	3.28%	14.50%

Nga të dhënat e paraqitura në *Tabelën GJ-L-6* vihet re se **vajzat kanë rezultate më të larta se djemtë, si gjatë vitit shkollor, po ashtu edhe në provimin e Maturës Shtetërore.**


Sipas analizës së bërë, për grupin e nxënësve të vlerësuar me notën **10**, gjatë vitit shkollor 2019-2020, vihet re se qëndrueshmëria e arritjeve, është më e lartë tek djemtë.

Numri i djemve të vlerësuar me notën **10** gjatë vitit shkollor, që kanë ruajtur të njëjtin rezultat edhe në provimin e Maturës Shtetërore, është më i madh, në krahasim me numrin e vajzave që kanë ruajtur vlerësimin me notën **10** edhe në provimin e Maturës Shtetërore.

Nga të dhënat e *Tabelës GJ-L-5* dhe *Tabelës GJ-L-6*, për lëndën e Gjuhës shqipe dhe letërsisë, sipas rezultateve të arritura në provimin e Maturës Shtetërore, rezulton se:



- ka një përqindje më të lartë të mbetësve për kategorinë “meshkuj”, krahasuar me kategorinë “femra”.
- ka një përqindje dominuese të nxënësve që kanë marrë notat **7, 8, 9 e 10**, të kategorisë “qytet”, kundrejt kategorisë “fshat”.
- ka një përqindje dominuese të nxënësve që kanë marrë notat **8, 9 e 10** të kategorisë “femra”, kundrejt kategorisë “meshkuj”.

Grafiku GJ-L-3



Raport Publik Mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2020

Grafiku GJ-L-4



Analiza e të dhënave të parashtruara më lart dhe krahasimi i arritjeve të nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore 2020, me arritjet Vjetore 2020, paraqet një lloj “*paqëndrueshmërie*” në rezultate.

Grafikët e mëposhtëm GJ-L-5 dhe GJ-L-6 japin shpërndarjen e pikëve të fituara në provimin e Maturës Shtetërore 2020, si dhe përqindjet përkatëse.

Grafiku GJ-L-5



Grafiku GJ-L-6



Treguesit e mësipërm provojnë se:

- asnjë nxënës nuk ka arritur të marrë pikët maksimale - 60 pikë;
- 0.006% e nxënësve janë vlerësuar me 57 pikë;
- 0.04% e nxënësve janë vlerësuar me 56 pikë;
- 0.05% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 10 pikë;
- 1.14% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 15 pikë;
- 22.64% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 25 pikë;
- 41.01% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 30 pikë;
- 71.69% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 38 pikë;
- 98.36% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 50 pikë.

2) Faktorë që kanë ndikuar në rezultatet e provimit të Gjuhës shqipe dhe letërsisë

Referuar analizës së të dhënave statistikore, ne mendojmë se, disa nga faktorët që kanë ndikuar në rezultatet e nxënësve në provimin e Maturës Shtetërore, për lëndën e Gjuhës shqipe dhe letërsi, janë:

- Situata e pandemisë së Covid 19, e cila krijoi mungesa në zhvillimin normal të procesit mësimor për një periudhë jo të shkurtër kohore dhe ndikoi jo pak në ngarkesën psikologjike të maturantëve të këtij viti.
- Hartimi i testit të Maturës Shtetërore 2020 sipas një modeli të paaplikuar më parë, vetëm me alternativa (në përshtatje me një kurrikul të reduktuar për shkak të situatës pandemike); formati i testit pati një shmangie të pjesshme nga ai i vitit të kaluar, me të cilin nxënësit dhe mësuesit ishin familjarizuar.
- Aplikimi i metodës së vlerësimit të testit nëpërmjet korrigjimit elektronik.
- Cilësia e mësimdhënies gjatë procesit mësimor. Kjo lidhet drejtpërdrejtë (si dhe faktorë të tjerë) me arritjet e nxënësve qytet/fshat si dhe në shkollat publike/private.
- Cilësia e kualifikimit të mësuesve në nivel kombëtar, por edhe mes qytetit/fshatit apo sistemit publik/privat.
- Shkalla e faktorëve motivues të mësuesve gjatë procesit mësimor.
- Cilësia e teksteve bazë për nxënësit, si dhe mësimdhënia e bazuar në disa lloje tekstesh të nxënësit.
- Vlefshmëria dhe besueshmëria në vlerësimin e nxënësve gjatë procesit mësimor.
- Cilësia e administrimit të provimit në mjediset e zhvillimit të provimit të Maturës Shtetërore.
- Niveli social – ekonomik i familjeve dhe komuniteteve përkatëse ku jetojnë nxënësit.

Arritjet e nxënësve në testin e Gjuhës shqipe dhe Letërsisë

Rezultatet e arritura në test, na ndihmojnë të nxjerrim përfundime të qarta për nivelin e arritjeve të nxënësve në testin e Gjuhës shqipe dhe të Letërsisë, në Maturën Shtetërore 2020. Mund të bëjmë një klasifikim të rezultateve të arritjes në parametrat: dobët, mjaftueshëm, mirë, shumë mirë dhe shkëlqyeshëm:

I. Niveli Dobët (përfshin nxënësit që janë vlerësuar me notën 4 në Testin e MSH).

Sipas statistikave (tabelës së shpërndarjes së pikëve), rezulton se 0.05% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 10 pikë. Si rezultat, ky grup nxënësish nuk e ka kapërcyer nivelin minimal të arritjeve.

II. Niveli Mjaftueshëm (përfshihen nxënësit që arrijnë **Nivelin e Parë**).

- 1.14% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 15 pikë.

Ky grup nxënësish kanë arritjet e mëposhtme:

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme.

Nxënësit:

- përdorin njohuritë për të kuptuar në mënyrë shumë të përgjithshme tekstin letrar (vetëm në linjën kryesore të tij, si identifikimin e heronjve kryesorë apo të tiparit kryesor), si dhe elementët përmbajtësorë, tekstin joletrar (psh: dallimin e faktit nga opinioni, identifikimin e elementëve pamore (foto apo ilustrime).

• ***Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.***

Nxënësit:

- dallojnë emrat e dygjinishëm, përdorimin e gabuar të ë-së në mbiemrat femërorë të formuar me prapashtesën – shëm/shme.

Kompetenca: Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit:

- identifikojnë rrjedhën e aksionit në vepër;
- identifikojnë tipare të karakterit të heroit kryesor.

➤ 22.64% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 25 pikë;

Ky grup nxënësish, përveç arritjeve të mësipërme, ka arritur edhe rezultatet e mëposhtme, sipas kompetencave përkatëse:

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme.

Nxënësit:

- identifikojnë hyrjen e një teksti.
- klasifikon në mënyrë sipërfaqësore informacionet kryesore të tekstit, në informacione të domosdoshme, apo të tepërta.
- renditin fjalitë sipas koherencës logjike.
- dallojnë idenë e një paragrafi të një teksti joletrar.
- zbulojnë raporte të thjeshta shkak-pasojë.

Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Nxënësit:

- kuptojnë raportin e titullit me fragmentin.
- dallojnë detajet e nevojshme për besueshmërinë e një teksti.
- zbulojnë mënyrën habitore të foljes në një përdorim të caktuar.
- raportin e përemrit dëftor me emrin të cilit i referohet.
- dallojnë lidhëzat bashkërenditëse përmbyllëse në struktura të dhëna sintaksore.
- dallojnë përcaktorin.

Kompetenca: Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit:

- shpjegojnë në mënyrë të thjeshtë qëndrimin e autorit ndaj temës që trajton
- identifikojnë motivin kryesor
- zbulojnë gjendjen shpirtërore të personazhit.

III. Niveli Mirë (përfshihen nxënësit që janë në Nivelin e Dytë)

- 41.01% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 30 pikë, të cilët në përputhje me kompetencat e arritjeve, zotërojnë aftësitë e mëposhtme:

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme.

Nxënësit:

- vlerësojnë saktësinë e informacionit në tekst.
- dallojnë tezën në një tekst argumentues.

Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Nxënësit:

- dallojnë rregullat e drejtshkrimit të ligjëratës së drejtë.
- dallojnë funksionin e lidhëzave në fjali.

Kompetenca: Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit:

- identifikojnë tonin e veprës dhe atmosferën që ai krijon.
- 71.69% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 38 pikë. Ky grup nxënësish kanë edhe arritje të tjera të mëposhtme, sipas kompetencave.

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme.

Nxënësit:

- realizojnë lidhjen mes një fragmenti të tekstit dhe ideve të tjera jashtë tekstit në një situatë të re;
- zbulojnë teknikat e organizimit të një eseje narrative.

Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Nxënësit:

- përshtatin në kohë e mënyrë gjymtyrët kryesore dhe të dyta të fjalisë

Kompetenca: Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit:

- zbulojnë qëndrimin e autorit kundrejt një personazhi.

IV. Niveli Shumë mirë (përfshin Nivelin e Tretë të arritjeve)

98.36% e nxënësve kanë marrë pikë që ndodhen në intervalin 0 – 50 pikë, të cilët në përputhje me kompetencat e arritjeve zotërojnë aftësitë e mëposhtme:

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme.

Nxënësit:

- vlerësojnë raportin mes informacioneve të marra nga burime të ndryshme.
- vlerësojnë burimet e informacionit.
- dallojnë në tekstin joletrar fjalët që tregojnë burimin e kumtimit.
- nxjerrin përfundime mbi fjalinë që kryen më mirë funksionin e një fjalie përmbyllëse në një tekst.

Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Nxënësit:

- dallojnë gjymtyrët e veçuara në fjali.

Kompetenca: Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit:

- dallojnë figurat e sintaksës poetike dhe funksionin e tyre në krijimin e imazheve në poezi (shkallëzimi, elipsa).
- identifikojnë tonin e veprës dhe atmosferën që ai krijon.

➤ 0.04% e nxënësve janë vlerësuar me 56 pikë dhe 0.006% të tjerë janë vlerësuar me 57 pikë

Ky grup nxënësish kanë edhe arritje të tjera sipas kompetencave të arritjes, të cilat janë renditur më poshtë.

Kompetenca: Të lexuarit e teksteve të ndryshme.

Nxënësit:

- dallojnë idetë që sillen përmes imazheve të reklamave.
- identifikojnë fjalitë që sjellin të dhëna të nënkuptuara në një tekst të dhënë.
- zbulojnë paragrafët sqarues në një tekst të caktuar.

Kompetenca: Përvetësimi i rregullave gramatikore, drejtshkrimore dhe të pikësimit.

Nxënësit:

- dallojnë ndërtimin e saktë të fjalive sipas raporteve sintaksore.
- identifikojnë fjalinë e zgjeruar me një rrethanor të veçuar.
- zbulojnë foljen kalimtare në një grup fjalish.

Kompetenca: Analiza, interpretimi dhe vlerësimi i teksteve të gjinive dhe llojeve të ndryshme letrare.

Nxënësit:

- evidentojnë në fragmente të tekstit mesazhet e nënkuptuara, si dhe zbulojnë vargun ilustrues në një grup alternativash të dhëna;
- dallojnë shfaqjen e elemente të simbolizmit në fragment;
- vërejnë tiparet që e bëjnë një vepër të llojit epik;
- zbulojnë të dhëna jo të drejtpërdrejta që mbart fragmenti lidhur me fatin e heroit;
- gjejnë funksionin e inversionit në vargjet e poemës epike, për të nxitur imazhe të caktuara;
- dallojnë funksionin e detajeve përshkruese në krijimin e imazheve në fragment.

➤ Shkëlqyeshëm (60 pikë).

Vihet re se numrin e plotë prej 60 pikësh nuk ka mundur ta fitojë asnjë nga nxënësit. Kjo lidhet kryesisht me mos përmbushjen e kompetencave që lidhen me:

- analizën në thellësi të personazhit, për të zbuluar thelbin e natyrës së tij;
- kuptimet e fjalëve në kontekste specifike;
- shterimin e të gjitha raporteve mes përmbajtjes ideore dhe formale, në krijimin e imazheve në një tekst;
- dallimin e përemrit të pacaktuar.

3) Arritjet e nxënësve në Gjuhë shqipe dhe letërsi - statistika krahasuese

Tabela GJ-L-7 jep informacion mbi mesataren e pikëve të fituara në test dhe shmangien mesatare, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore dhe shmangien mesatare, si dhe notën mesatare Vjetore dhe shmangien mesatare, në nivel ZVA.

Ndërkohë, mesatarja e pikëve të fituara nga nxënësit në nivel kombëtar është **32.86** pikë, nota mesatare Vjetore në nivel kombëtar është **7.17**, ndërsa nota mesatare e provimit të Maturës Shtetërore në nivel kombëtar është **7.20**.

Tabela GJ-L-7

Nr.	ZVA	Pikët e fituara në test		Nota e Maturës		Nota Vjetore	
		Mesatarja e pikëve	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare	Nota mesatare	Shmangia mesatare
1	Belsh	32.72	6.64	7.16	0.94	6.76	1.52
2	Berat	31.35	9.05	6.95	1.28	7.28	1.77
3	Bulqizë	29.60	8.24	6.71	1.18	7.06	1.70
4	Cërrik	30.95	7.66	6.9	1.10	6.82	1.60
5	Delvinë-Finiq	32.78	7.44	7.17	1.06	7.25	1.76
6	Devoll	35.71	8.58	7.58	1.20	7.08	1.67
7	Dibër	28.89	7.41	6.61	1.06	6.68	1.57
8	Divjakë	32.24	8.63	7.09	1.23	7.00	1.70
9	Durrës	33.31	8.81	7.23	1.23	7.08	1.67
10	Elbasan	31.18	9.18	6.93	1.29	6.89	1.71
11	Fier	33.86	9.14	7.30	1.27	7.29	1.71
12	Gramsh	33.87	9.49	7.30	1.32	7.45	1.73
13	Gjirokastër-Libohovë-Dropull	32.07	8.75	7.06	1.24	7.9	1.67
14	Has	35.07	7.64	7.49	1.08	7.16	1.67
15	Kamzë	29.73	7.34	6.73	1.05	7.95	1.54
16	Kavajë	35.57	8.28	7.55	1.16	6.75	1.79
17	Klos	30.98	8.45	6.90	1.21	7.41	1.67
18	Kolonjë	32.41	8.83	7.11	1.25	6.61	1.81
19	Korçë - Pustec	33.99	9.38	7.32	1.31	7.05	1.62
20	Krujë	33.33	8.44	7.24	1.20	7.02	1.70
21	Kuçovë	30.85	7.68	6.89	1.08	7.21	1.64
22	Kukës	33.94	7.60	7.33	1.08	7.48	1.76
23	Kurbin	34.02	7.61	7.34	1.08	7.54	1.69
24	Lezhë	33.21	8.22	7.22	1.17	7.32	1.78
25	Librazhd	31.79	8.70	7.02	1.24	6.82	1.61
26	Lushnje	32.74	9.37	7.14	1.31	7.48	1.83
27	Malësi e Madhe	30.74	8.67	6.87	1.24	6.58	1.58
28	Maliq	29.67	7.82	6.72	1.12	6.69	1.61

Raport Publik Mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2020

29	Mallakastër	34.58	8.03	7.42	1.13	7.14	1.70
30	Mat	29.29	9.08	6.65	1.30	7.02	1.70
31	Mirditë	30.04	8.08	6.77	1.15	6.80	1.61
32	Patos	31.28	8.43	6.94	1.20	7.26	1.74
33	Peqin	32.86	8.35	7.17	1.17	7.76	1.64
34	Përmet-Këlcyrë	32.08	8.34	7.06	1.18	6.77	1.70
35	Përrenjas	30.39	8.31	6.81	1.20	7.31	1.67
36	Pogradec	32.06	9.26	7.05	1.31	7.14	1.75
37	Pukë-Fushë Arrëz	32.41	7.70	7.11	1.09	6.96	1.78
38	Roskovec	33.16	8.08	7.21	1.14	7.36	1.81
39	Rrogozhinë	33.20	7.53	7.23	1.08	7.4	1.50
40	Sarandë-Konispol	33.02	9.62	7.18	1.34	7.15	1.78
41	Selenicë	31.63	8.79	6.99	1.24	6.57	1.59
42	Skrapar - Poliçan	31.58	8.25	7.00	1.17	6.99	1.70
43	Shijak	32.14	7.95	7.07	1.13	7.15	1.51
44	Shkodër	32.82	8.83	7.16	1.25	6.97	1.55
45	Tepelenë-Memaliaj	31.42	9.01	6.96	1.28	7.38	1.84
46	Tiranë	34.34	8.95	7.37	1.25	7.51	1.66
47	Tropojë	31.71	7.41	7.02	1.07	7.45	1.81
48	Ura Vajgurore	30.89	8.53	6.89	1.22	6.85	1.70
49	Vau i Dejës	28.65	7.61	6.57	1.10	6.48	1.56
50	Vlorë-Himarë	34.54	9.15	7.40	1.27	7.44	1.76
51	Vorë	30.34	7.78	6.82	1.11	6.83	1.48
	Në rang Kombëtar :	32.86	8.83	7.17	1.24	7.20	1.7

Të dhënat e Tabelës GJ-L- 7 tregojnë se:

- **18** ZVA kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **mbi** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si: ZVA Vlorë-Himarë, Durrës, Tiranë, Gramsh, Korçë-Pustec, Has, Fier, Devoll, Lezhë etj.
- **12** ZVA kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **relativisht nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si: ZVA Belsh, Divjakë, Kolonjë, Lushnje, Pogradec etj.
- **31** ZVA kanë mesatare të pikëve të fituara në test nga nxënësit e tyre **nën** vlerën e mesatares së pikëve në nivel kombëtar, si: ZVA Vau i Dejës, Selenicë, Skrapar-Poliçan, Malësi e Madhe, Bulqizë, Tropojë, Klos, etj.

Tabela GJ-L- 8 jep informacion mbi kalueshmërinë në provimin e maturës në nivel ZVA, notën mesatare në provimin e Maturës Shtetërore, notën mesatare Vjetore, si dhe diferencën mes tyre (NM-NV).

Tabela GJ-L-8

Nr.	DAR/ZA	Kalueshmëria në provimin e Maturës	Nota Mesatare	Nota Mesatare	Diferenca e Notës së Maturës me Vjetoren
			e Maturës (NM)	Vjetore (NV)	NM-NV
1	Belsh	100.00%	7.17	6.76	0.40
2	Berat	99.59%	6.96	7.29	-0.33
3	Bulqizë	98.08%	6.72	7.06	-0.34
4	Cërrik	99.51%	6.91	6.82	0.09
5	Delvinë-Finiq	100.00%	7.17	7.25	-0.08
6	Devoll	100.00%	7.58	7.08	0.50
7	Dibër	99.81%	6.61	6.69	-0.07
8	Divjakë	100.00%	7.09	7.01	0.08
9	Durrës	99.84%	7.23	7.09	0.15
10	Elbasan	99.70%	6.93	6.89	0.04
11	Fier	99.71%	7.31	7.29	0.02
12	Gjirokastër-Libohovë-Dropull	100.00%	7.06	7.16	-0.10
13	Gramsh	100.00%	7.31	7.46	-0.15
14	Has	99.43%	7.50	7.96	-0.46
15	Kamzë	99.65%	6.74	6.75	-0.01
16	Kavajë	99.72%	7.56	7.42	0.14
17	Klos	100.00%	6.91	6.61	0.30
18	Kolonjë	100.00%	7.12	7.63	-0.51
19	Korçë - Pustec	100.00%	7.33	7.05	0.28
20	Krujë	93.67%	7.24	7.02	0.22
21	Kuçovë	100.00%	6.89	7.22	-0.32
22	Kukës	99.83%	7.34	7.47	-0.13
23	Kurbin	99.60%	7.35	7.55	-0.20
24	Lezhë	99.73%	7.23	7.33	-0.10
25	Librazhd	100.00%	7.02	6.83	0.19
26	Lushnje	99.86%	7.15	7.48	-0.33
27	Malësi e Madhe	99.20%	6.87	6.59	0.29
28	Maliq	99.61%	6.72	6.69	0.03
29	Mallakastër	100.00%	7.42	7.14	0.28
30	Mat	99.01%	6.66	7.03	-0.37
31	Mirditë	100.00%	6.78	6.80	-0.03
32	Patos	100.00%	6.95	7.26	-0.31
33	Peqin	99.31%	7.17	7.77	-0.59

Raport Publik Mbi Arritjet e Nxënësve MSH 2020

34	Përmet-Këlcyrë	100.00%	7.07	6.77	0.30
35	Përrenjas	98.79%	6.82	7.31	-0.49
36	Pogradec	98.94%	7.05	7.14	-0.09
37	Pukë-Fushë Arrëz	100.00%	7.12	6.97	0.15
38	Roskovec	100.00%	7.22	7.37	-0.15
39	Rrogozhinë	100.00%	7.24	7.40	-0.16
40	Sarandë-Konispol	100.00%	7.19	7.16	0.03
41	Selenicë	100.00%	7.00	6.57	0.43
42	Shijak	99.12%	7.08	7.16	-0.08
43	Shkodër	99.77%	7.17	6.98	0.19
44	Skrapar - Poliçan	100.00%	7.00	7.00	0.00
45	Tepelenë-Memaliaj	100.00%	6.97	7.39	-0.42
46	Tiranë	99.86%	7.38	7.52	-0.14
47	Tropojë	99.59%	7.02	7.45	-0.43
48	Ura Vajgurore	99.10%	6.90	6.85	0.05
49	Vau i Dejës	99.43%	6.58	6.49	0.09
50	Vlorë-Himarë	99.74%	7.41	7.44	-0.03
51	Vorë	100.00%	6.82	6.84	-0.02

Të dhënat e Tabelës GJ-L-8 tregojnë se:

- **24 ZVA** kanë arritje në provimin e Maturës Shtetërore **më të ulëta** se arritjet Vjetore. Në vazhdim, përmendim ZVA-të: Peqin, Tropojë, Gramsh, Bulqizë, Berat, Has, Kuçovë, Lushnjë, Përrenjas etj.
- **27 ZVA** kanë pasur një **rritje** relativisht **të lehtë** (mesatarisht 0.22 njësi notë) nga nota mesatare vjetore, në krahasim me notën mesatare të Maturës Shtetërore

Tabela GJ-L-9 jep informacion mbi notën mesatare në provimin e maturës në nivel ZVA, për profilet e shkollave: gjimnaz; gjimnaz gjuhësor dhe seksioni 2-gjuhësh; artistike, koreografike dhe sportive; teknike-profesionale; gjimnaz me kohë të shkurtuar.

Nga rezultatet e Tabelës GJ-L-9 shihet se:

- nivelet **më të ulëta** të arritjeve mesatare në provimin e Maturës Shtetërore 2020, u përkasin nxënësve të Gjimnazit më kohë të shkurtuar dhe Teknike - Profesionale.

